

**UNITED NATIONS**  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



**NATIONS UNIES**  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies  
au Kosovo

**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT**

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**LIGJI NR. 2002/6**

**PËR AKTIVITETET E TREGËTISË ME JASHTË**

Kuvendi i Kosovës,

Duke u bazuar në Rregulloren nr.2001/9 të dt. 15 majit 2001 Mbi Kornizën Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, veçanërisht nenet 5.1 (d), 5.7, 9.1.26.(a), 9.3.3, 11.2 dhe tutje;

Në bazë të Rregullos nr.1999/1 dt. 25 korrik 1999 Mbi Autorizimet e Misionit të Përkohshëm të OKB-së në Kosovë; të plotësuar dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/24 të dates 12 dhjetor 1999 Mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë, të plotësuar;

Duke marrë parasysh se dispozitat e këtij ligji do të jenë pa paragjykime kundrejt të drejtave dhe imunitetit të UNMIK-ut dhe KFOR-it të nevojshme për përmbushjen e mandatit të tyre në bazë të Rezolutës të Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) dhe Kornizës Kushtetuese;

Duke reafirmuar se termet e përcaktuara në Nenin 2 të këtij ligji dhe akteve të dala nga ky ligj do të interpretohen në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) dhe Kornizës Kushtetuese; dhe

Me qëllim të promovimit të zhvillimit të një ekonomie të shëndoshë të tregut në Kosovë duke siguruar që përmbajtja e rregullave dhe rregulloreve të cilat ndikojnë në tregëtinë ndërmjet Kosovës dhe rajoneve jashtë Kosovës të zhvillohen dhe implementohen në përputhshmëri me përvojat më të mira ndërkombëtare dhe kërkesat e Organizatës Botërore të Tregëtisë dhe Bashkimit Evropian, Kuvendi i Kosovës:

Miraton Ligjin për aktivitetet e tregëtisë me jashtë, si vijon:

## Kapitulli 1 Dispozitat e Përgjithshme

### Neni 1 Qëllimi, aplikimi dhe fushëveprimi

1.1 Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë që, rregullat të cilat i rregullojnë aktivitetet e tregëtisë ndërmjet Kosovës dhe rajoneve jashtë Kosovës, të jenë në përputhshmëri me standardet e Organizatës Botërore të Tregëtisë dhe Bashkimit Evropian.

1.2 Ky ligj vlen për të gjitha autoritetet publike dhe ndërmarrjet publike si dhe ndërmarrjet dhe personat tjerë të cilët janë të angazhuar ose inkuadruar në tregëti dhe veprimtari komerciale brenda apo që kanë ndikim ekonomik brenda territorit të Kosovës.

### Neni 2 Definicionet

Kurdo që përdoren në këtë ligj, secila nga shprehjet në vijim ka kuptimin e përshkruar më poshtë, përveq nëse kontesti në të cilin një shprehje e tillë shfaqet, qartë ka një kuptim tjetër.

“*Leja e Veprimtarisë*” nënkupton një autorizim, të lëshuar nga autoriteti përkatës licenses, e cila e autorizon poseduesin e lejes së tillë, që në pajtueshmëri më kushtet e përcaktuara në leje të merret me një lloj të caktuar të biznesit apo të ndonjë aktiviteti tjetër.

“*Mallrat me shenjë tregëtare të rrejshme*” nënkuptojnë mallrat që, pa autorizim përkatës, bartin markë tregëtare identike apo shumë të ngjashme me markën tregëtare që ka qenë në mënyrë valide e regjistruar në BE apo në një shtet anëtar të BE-së.

“*Vendi i Destinimit*” nënkupton shtetin e huaj ose rajonin e jashtëm ku mallërat përkatëse do të përdoren, punohen, transformohen apo përpunohen; nëse nuk do të ketë baza të mjaftueshme për ta përcaktuar këtë, atëherë vendi i destinacionit do të konsiderohet shteti i fundit i huaj apo rajoni i jashtëm ku dihet se mallrat përkatëse do të jenë dërguar.

“*Legjislacioni doganor në Kosovë*” do të thotë legjislacion që ka për lëndë kryesore vendosjen e tarifave doganore, vlerësimin e detyrimeve doganore apo procedurat dhe rregullat që qeverisin çështje të tjera standarde.

“*BE*” nënkupton Unionin Evropian.

“*Eksporti*” apo “*Eksportimi*” nënkupton lëvizjen apo lëvrimin e mallrave jashtë territorit të Kosovës dhe në rajonin e jashtëm.

“*Eksportues*” nënkupton personin fizik dhe juridik apo ndërmarrjen që kryen apo nxit tjetrin që të ndërmarrë një eksportim.. Në rast se eksportimi kërkohet me qëllim të

përmbushjes së një marrëveshje ndërmjet një rezidenti dhe një jo-rezidenti që përfshin përvetësimin apo blerjen e mallrave, atëherë vetëm rezidenti konsiderohet si eksportues. Një person fizik apo ndërmarrje që vepron vetëm si bartës, transportues apo ndërmjetës i mallrave, nuk do të konsiderohet si eksportues i atyre mallrave.

*“Autorizimi për eksportim”* nënkupton lejen e nxerrë nga organi përkatës lejedhënes që e autorizon poseduesin të kryej, në pajtim me kushtet e përcaktuara sakt, veprimtaritë e veçanta të caktuara të eksportit

*“Rajon i jashtëm”* nënkupton çdo rajon jashtë territorit të Kosovës.

*“Aktiviteti i tregëtisë me jashtë”* përfshinë tregëtinë, biznesin, kontratat, transaksionet dhe veprimtaritë tjara që ngërthejnë lëvizjet e mallrave, pasurinë tjetër të prekshme, pasuritë tjera të paprekshme, të drejtat e pasurisë së paprekshme dhe shërbimet në mes të territoreve të jashtme dhe territorit të Kosovës.

*“Shtet i jashtëm”* do të thotë (i) çdo shtet apo teritor i huaj më shërbim të veçantë doganor, dhe (ii) çdo teritor ose nën-ndarje politike të një shteti të tillë apo territori të huaj me shërbim të veçantë doganor.

*“Ari”* nënkupton arin e rafinuar dhe lëgurat e arit në formë të shufrave gjysëm –të përpunuara apo gjysëm-të fabrikua, si dhe monedhave të arit që nuk kanë vlerë të njohur apo domethënëse për koleksion.

*“Mallrat”* nënkuptojnë pasuri të tundshme të prekshme, artikujt dhe pasurinë personale të lujtshme, rrymën elektrike, por jo letrat me vlerë, letrat tregëtare apo parat e gatshme (kartmonedha apo monedha) dhe ari; me kusht që, sidoqoftë, karmonedhat dhe monedhat të kenë vlerë domethënëse dhe të njohur koleksionare.

*“Qeveria”* nënkupton Qeverinë e përcaktuar në nenin 1.5 ( c ) të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2001/9 mbi “ Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë”, dhe çdo organ ekzekutiv publik suksesor.

*“Importi”* apo *“Importimi”* nënkupton lëvizjen apo dërgimin e mallrave në një rajon të jashtëm dhe në territorin e Kosovës. Lëvizja apo dërgimi i mallit nga një zone e përjashtuar nga taksat doganore, zona e lire tregtare ose trafiku i doganave dhe në tregëtinë e zakonshme të Kosovës do të përbën një importim nëse malli i tillë më parë ka lëvizur ose është lëvruar jasht zonës së lirë doganore, zonës së lirë tregëtare ose trafikut të doganave.

*“Importuesi”* nënkupton një person fizik apo ndërmarrje që kryen apo nxit tjetrin të kryej një importim të mallit. Në rast se nga importimi kërkohet me qëllim të përmbushjes së një marrëveshje ndërmjet një rezidenti dhe jorezidenti duke përfshirë për përvetësimin apo blerjen e mallërave, atëherë vetëm rezidenti do të konsiderohet importues. Personi fizik apo ndërmarrja që vepron vetëm si bartës, transportues apo ndërmjetës i mallrave nuk do të konsiderohet si importues i atyre mallrave.

“*Leja e importit*” nënkupton lejen e nxjerrur nga autoriteti përkatës lejdhënës që lejon bartësin të kryej në pajtim me kushtet e përcaktuara në te veprimtari importi të përcaktuara në mënyrë të sakt.

“*Autoriteti liçensues*” nënkupton autoritetin publik të përcaktuar me këtë ligj apo me ndonjë akt tjetër normativ, i cili ka autorizim dhe përgjegjësi për dhënien e lejes së tillë.

“MTI” nënkupton Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe çdo organ publik që del nga ajo.

“*Rezident*” nënkupton dhe përfshin:

- a. Personin fizik i cili është banues, apo ka vendbanim të përhershëm në territorin e Kosovës;
- b. Ndërmarrjen, përveq një dege apo një zyre të ndërmarrjes nëse ndërmarrja e tillë (i) është regjistruar në pajtim me aktet normative aplikative të Kosovës, dhe nëse (ii) ka selinë qendrore, emrin kryesor të biznesit, librat dhe regjistrat në territorin e Kosovës; dhe
- c. Degën apo zyrën e ndërmarrjes, pa marrë parasysh nëse një ndërmarrje e tillë është apo jo-rezidente, nëse (i) dega e tillë ose zyrja është themeluar dhe regjistruar në pajtim me aktin normative aplikativ të Kosovës; (ii) administrimi i përditëshëm dhe menaxhimi i degës apo zyrës së tillë -kryhet faktikisht në adresën e regjistruar në Kosovë, dhe (iii) librat e veçanta dhe regjistrat mbi veprimtarinë e degës së tillë ose zyrës udhëhiqen në adresën e tillë.

“*Jo-rezident*” nënkupton:

- a. Personin fizik i cili nuk është banor dhe nuk ka vendbanim të zakonshëm në Kosovë;
- b. Një ndërmarrje e cila nuk i përmbush kërkesat e caktuara në paragrafin “b” nën definicionin e “rezidentit”.
- c. Një degë apo zyrë përfaqësuese e një ndërmarrje rezidente, nëse dega e tillë apo zyra përfaqësuese që gjindet në një rajon të jashtëm, nuk i përmbushë kërkesat e përcaktuara në paragrafin “c”, nën definicionin e “Rezidentit”.

“*Akt normativ*” nënkupton (i) çdo ligj, dekret, rezolutë, akt normativ, akt nën-normativ, rregullore, udhëzim administrativ, udhëzim, rregull, urdhëresë, apo akt tjetër i cili njihet si akt që ka fuqi normative, mbrenda territorit të Kosovës nga çfarëdo autoriteti publik dhe (ii) çdo marrëveshje ndërkombëtare të cilën ligji ndërkombëtar e konsideron si të detyrueshme në Kosovë.

“*Organi lejdhënës*” nënkupton autoritetin publik të përcaktuar në këtë ligj, apo aktin tjetër normativ që ka obligim apo përgjegjësi për dhënien e një leje importi apo eksporti;

*“Produkte pirate të së drejtës së autorit”* nënkuptohen mallrat të cilat përmbajnë apo bartin materiale të të drejtës së autorit pa autorizimin e pronarit të materialeve të të drejtave të tilla të autorit nëse shitja apo prodhimi i mallrave të tilla në një shtet anëtar të BE-së do të shkelte të dretën e autorit ose ligjin i cili e themelon të drejtën e tillë;

*“Autoriteti Publik”* nënkupton çdo organ ekzekutiv publik, autoritet publik, ministri, departament, agjenci apo pushtet tjetër publik i cili ushtron, në pajtim me çdo akt normativ pushtetin ekzekutiv, legjislativ, rregullues, administrativ apo ndonjë pushtet tjetër.

Fjala *“autoritet publik”* gjithashtu do të përfshijë edhe çfarëdo organizate private apo kuazi-publike në atë masë sa organizata e tillë të punojë si një autoritet i tillë si pasues i një dhënie të autoritetit nga një akt normativ apo një akt nën-normativ, apo si pasuese e delegimit të autoritetit nga një autoritet publik.

*“Ndërmarrje publike”* nënkupton autortitetin publik ose ndërmarrjen në pronësi apo të kontrolluar nga autoriteti publik, deri në masën që autoriteti publik ose ndërmarrja është e përfshirë në zhvillimin e veprimtarisë komerciale, biznese ose ekonomike brenda ose që kanë ndikim brenda territorit të Kosovës;

*“Kuoti”* nënkupton kontigjentin, kontigjentin e tarifës apo kufizimin tjetër numerik, të bazuar në një vlerë e cila i detyrohet çdo lloji të veprimtarisë së tregëtisë me jashtë. *“Kuotë”*, do të përshijë çdo masë tjetër e cila me arësye pritet që të dërgojë kah apo që të ndikojë në një kufizim të tillë.

*“Masë restriktive”* nënkupton kufizim, ndalim, kërkesë apo masë e përshkruar në nenin 3, paragrafi 2, të këtij ligji.

*“Masat e veçanëta tregtare”* nënkuptojnë anti-dampingun, kompensimin dhe masat mbrojtëse të autorizuara sipas Kapitullit IV, Pjesës 4 të këtij ligji.

*“Tranzit”* nënkupton transportimin e mallërave nga një rajon i jashtëm nëpër territorin e Kosovës, në një rajon të jashtëm pa hyrë këto mallëra në tregun e zakonshëm të Kosovës.

*“Ndërmarrjet”* nënkupton çdo person juridik, organizatë biznesi, ortakëri, ndërmarrje e përbashket , ndërmarrje publike, shoqatë, projekt, degë, zyrë apo organizata tjera.

*“OBT”* nënkupton Organizatën Botërore të Tregëtisë.

“Normë Teknike” në kuptim të nenit 13, do të thotë akt normativ, duke përfshirë dispozitën në fuqi për zbatimin e saj, që përcakton kriterin obligues të cilin lloji apo kategoria e vacant e mallrave, pa marrë parasysh origjinën, duhet ta plotësojnë, duke përfshirë- por pa u kuifizuar në kërkesat lidhur me karakteristikat e prodhimeve, specifikacionin teknik, terminologjinë, simbolet, ambalazhimin, markimin ose kërkesën për etiketë kur ato vlejnjë për prodhimin ose metodën e prodhimit.

“Standardi i prodhimit” në kuptimin të nenit 14 nënkupton çdo document (i) që është nxhjern ose miratuar nga organi i njohur për hartimin e standardit, (ii) që përcakton- me qëllim të përdorimit të rregullt dhe të shpeshtë- normat-direktivat apo cilësitë e prodhimeve, proceset gjedhëse dhe metodat e prodhimit; duke përfshirë normat, direktivat ose karakteristikat lidhur me terminologjinë, simbolet, ambalazhimin, ose markimin ose kërkesat e etiketimit që vlejnjë për prodhimet, përpunimin ose metodën e prodhimit, dhe (iii) e cila përputhje nuk kërkohet as nuk obligohet me aktin normative ose autoritetin publik.

## **Kapitulli 2**

### **Normat themelore të veprimtarinë së tregtisë me jasht**

#### **Neni 3**

##### **Parimi themelor i tregtisë së lirë dhe biznesit**

Autoriteti publik apo aktet normative nuk mund të imponojnjë restriksione, ndalime ose kushtëzime në asnje aktivitet tregtar me jashtë ose dëmtimin apo vendosjen e kushteve mbi aftësinë apo të drejtën e cilitdo resident apo jo-rezident për të marë pjesë apo të merret me aktivitete tregtare me jashtë, përvec nëse ky ligj në vecanti kërkon këtë apo në një mënyrë tjetër lejon këtë.

#### **Neni 4**

##### **Kufizimet e përgjithëshme të masave restriktive**

4.1 Nëse dispozita e këtij ligji, posaçerisht kërkon apo autorizon vendosjen e masës restriktive që përndryshe do të ishte në kundërshtim me nenin 3, Qeveria, do të ose mundet, kur është e nevojshme të nxjerrë akt normativ mbi themelimin e masës së tillë restriktive; me kusht që, sidoqoftë, çdo masë e tillë restrictive e themeluar kështu duhet të jetë në pajtim me kriteret vijuese:

- (a) Duhet të jetë qartë e lejuar dhe në pajtim dispozitën përkatëse të këtij ligji;
- (b) Duhet të jetë qartë në lidhje me dhe qartë e domosdoshme për arritjen e qëllimit të përcaktuar me një dispozitë të tillë;
- (c) Qëllimi dhe lloji i saj të jetë i kufizuar gjer në minimumin e nevojshëm për artitjen e këtij qëllimi;
- (d) Implemtimi i saj të bëhet në atë mënyrë që të krijoj përzierjen sa më të vogël të mundëshme dhe vendosjen e caktimin e ngarkesës sa më të të vogël të

mundshme lidhur me aktivitetet e tregëtisë me jashtë dhe lirinë e përgjithshme të veprimtarisë ekonomike;

(e) Nuk do të jetë në kundërshtim me asnjë marrëveshje ndërkombëtare e cila e obligon Kosovën;

(f) Do të jetë në pajtim me kërkesat e obligueshme të marrëveshjeve të OBT-së; dhe

(g) Do të jetë, aq sa është e mundur, në pajtim me çdo kriter tjetër të aplikueshëm në BE ndaj masës së tillë restriktive.

4.2 Nëse një masë e propozuar restriktive ka potencial të mjaftueshëm që të ndikojë materialisht në marrëdhëniet me jashtë, Qeveria do të informojë UNMIK-un mbi aktivitetet e saj që kanë të bëjnë me përpilimin e akteve plotësuese normative që vendosin masa restriktive.

4.3 Masa e tillë restrictive nuk mund të ndikojë negativisht në kryerjen e obligimeve ekzistuese kontraktuese në kohën kur masa e tillë restrictive është adoptuar përveç kur arritja e qëllimit publik të masës së tillë restrictive do të ishte më tepër se e parëndësishme e rrezikuar me kryerjen e padëmshme të obligimit të tillë.

4.4 Masa restrictive do të shfuqizohet ose fusha e zbatimit të saj do të reduktohet aq dhe deri sa arsyet që justifikojnë ekzistencën ose qëllimin e zbatimit të pushojnë së ekzistuari ose përndryshe bëhen të parëndësishme.

4.5 Nëse një masë kufizuese ose metoda e saj e implementimit nuk ka element diskriminues anti-damping ose tregëtar kufizues ose efekt i cili nuk është qenësisht i qartë për arritjen e qëllimit të dispozitës përkatëse të këtij ligji, masa e tillë apo mënyra e implementimit të saj do të jetë qoftë e shmangshme, ose nëse është e mundëshme me përpikëri të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë që të eliminoj ose zvogloj gjer në minimum një element apo efekt të tillë të parëndësishëm diskriminues, anti-konkurent apo tregëtar kufizues.

4.6 Të gjitha masat restriktive duhet të merren dhe publikohen në një mënyrë krejtësisht transparente.

4.7 Nëse një akt plotësues normativ i nxjerrë nën autoritetin e këtij duhet të zbatohet në kufi në mënyrë që të hyjë në fuqi, Qeveria do të përcjellë aktin e tillë plotësues normativ tek Shërbimi Doganor i UNMIK-ut së bashku me një kërkesë në të cilën kërkohet që Shërbimi Doganor i UNMIK-ut të ndërmarrë hapat e duhur për të zbatuar aktin e tillë plotësues normativ.

## Neni 5

### Autoriteti për implementimin e masave restriktive

5.1 MTI do të jetë autoriteti i vetëm publik i cili është i autorizuar të zbatojë masat restriktive.

5.2 Nëse MTI ka mungesë të personelit të trajnuar dhe të duhur ose nuk ka aftësi teknike të përgatisë apo të zbatojë një lloj të veçantë të masës restrictive Qeveria do të delegojë gjithë apo një pjesë të autoritetit të saj të zbatojë një masë të tillë kufizuese një organi tjetër publik; Sidoqoftë MTI do të sigurojë që aktivitetet e tilla të kryhen në pajtueshmëri të plotë me këtë ligj dhe çdo akt tjetër normativ ose akte të zbatueshme.

5.3 Qeveria do të sigurojë që MTI dhe autoritetet tjera publike që kanë interes legjitim dhe të dukshëm në përgatitjen dhe implementimin e masës restriktive, të bashkëpunojnë lidhur me përgatitjen e procedurës, kritereve dhe mekanizmave të kërkuar për implementimin e duhur të saj. Sidoqoftë, MTI do të jetë përgjegjëse për të siguruar që aktivitetet e tilla të zhvillohen në përputhshmëri me këtë ligj dhe çdo akt tjetër normativ.

5.4 MTI do të sigurojë që përgatitja dhe implementimi i të gjitha masave restrictive të jenë të zhvilluara dhe të bashkrenduara në mënyrën që të jenë të lire nga procedurat dhe kërkesat e dyfishta dhe të tepërta.

5.5 MTI do të themelojë dhe udhëheqë zyrën e informimit publik e cila do të jetë e hapur për çdo person fizik gjatë orarit të rregullt të punës nga e hëna gjer të premtën, të mirëmbajë koleksionin e kopjeve të këtij ligji, të gjitha akteve normative të nxjera në bazë të këtij ligji, të gjitha masat restriktive, dhe të gjitha rregullat, rregulloret, procedurat, kërkesat dhe kriteriet që kanë të bëjnë me implementimin e këtij ligji, akteve të tilla normative dhe masave të tilla kufizuese. MTI, gjithashtu do të mbajë dhe udhëheqë faqe në rrjetin e internet (web-faqe) në mënyrë të rregullt dhe të përshtatëshme për shfrytëzuesin, nëpërmjet të cilës çdo person mund të marrë kopje elektronike të dokumenteve të lartpërtheksuara.

## Neni 6

### Rregullat e përgjithëshme lidhur me lejet për import dhe eksport

6.1 Nëse dispozita e këtij ligji apo ndonjë akti tjetër normativ i cili është nxjerrë në përputhje me këtë ligj përcakton që një leje importi apo eksporti kërkohe për zbatimin apo kryerjen e një transaknsioni të eksportit apo importit, autoriteti përkatës lejdhënës, përveç kur parashihet në paragrafin 2 më poshtë I lëshon lejen e kërkuar aplikuesit përkatës.

6.2 Organi gjegjës për dhënjen e lejes do të refuzojë aplikacionin për dhënien e lejes së kërkuar për import apo eksport vetëm nëse (i) një dispozitë specifike e këtij ligji apo akti përkatës normativ mundëson një refuzim të tillë apo (ii) autoriteti gjegjës lejdhënës i artikulon qartësisht me shkrim arësyet bindëse që provojnë që dhënia e lejes së kërkuar kërkesit përkatës do të rrezikonte materialisht qëllimin e dispozitës e cila përcakton kërkesën e lejes.

6.3 Në raste se autoriteti lejdhënës refuzon një aplikacion për një leje të importit apo eksporti, organi për dhënjen e lejes duhet ti sigurojë aplikuesit përkatës përgjigjen me shkrim mbi shkaqet e bazës juridike dhe arësyet për refuzimin e aplikacionit.



6.4 Akt normativ i nxjerrë në pajtim me këtë ligj, deri në shkallën e lejuar me këtë ligj, të bëjë lëshimin e një leje për import apo eksport varësisht nga kushtet e plotësuara të aplikantit për t'i përmbushur kriteriet e veqanëta të përshkruara në një akt të tillë normativ; me kusht që, sidoqoftë që të gjitha kriteriet e tilla të jenë transparente dhe qartësisht e kryesisht të nevojshme për arritjen e qëllimit publik që theksohet në lejen gjegjëse për import dhe eksport.

6.5 Brenda tridhjet (30) ditësh nga data e refuzimit të kërkesës për import apo eksport nga autoritetet për lëshimin e lejeve, parashtruesi i kërkesës mund të bëjë kërkesën për rishqyrtim tek autoritetet për lëshimin e lejeve. Autoritetet për lëshimin e lejeve do t'i konfirmojnë parashtruesit të kërkesës kohën dhe datën e marjes së kërkesës për rishqyrtim.

Autoritetet për lëshimin e lejeve do të marrin vendim mbi kërkesën për rishqyrtimin e refuzimit të kërkesës për leje importi apo eksporti brenda tridhjet (30) ditësh nga marja e kërkesës për rishqyrtim. Në rast se autoriteti për lëshimin e lejeve refuzon kërkesën për rishqyrtim për leje importi apo eksporti, autoriteti për lëshimin e lejeve duhet të lëshojë një deklaratë të detajuar me shkrim ku do të ceket justifikimi ligjor dhe arsyet për refuzim.

Brenda tridhjet (30) ditësh nga data e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga autoritetet për lëshimin e lejeve në bazë të nenit 6.3 të këtij ligji, parashtruesi i kërkesës mund të bëjë kërkesë në MTI për rishqyrtim dhe vendim nga autoritetet për lëshim e lejeve. MTI do t'i konfirmojë me shkrim parashtruesit të kërkesës mbi kohën dhe datën e marjes së kërkesës për rishqyrtim. Ky nen 6.4 nuk do të aplikohet aty ku autoriteti për lëshimin e lejeve është vet MTI.

MTI do të marrë vendim mbi kërkesës e parshtruar për rishqyrtimin e vendimit të autoriteteve për lëshimin e lejeve sipas nenit 6.3 brenda tridhjet (30) ditësh nga data e marjes së kërkesës për rishqyrtim. Në rast se MTI refuzon kërkesën për rishqyrtimin e vendimit të autoriteteve për lëshimin e lejeve, MTI duhet të japë arsyet në një deklaratë të detajuar me shkrim ku do të ceket justifikimi ligjor dhe arsyet për refuzim.

Vendimi i MTI në bazë të nenit 6.4 ose 6.5 më sipër, do të jetë rishikohet nga organet gjyqësore në pajtim me ligjet në fuqi.

6.6 Asnje person apo ndërmarrje që është e autorizuar me një leje eksporti apo importi nuk lejohet që të bartë lejen në personin apo ndërmarrjen tjetër.

## Neni 7

### Ndalimi i kuotave; kuotat e papreferueshme; caktimi i kuotave

7.1 Përveq kur në mënyrë të veçantë ose shprehimisht lejohet nga ky ligj apo nga një dispozitë e një akti tjetër normativ, asnjë autoritet publik apo akt normativ nuk mundet që të vendosë, implementojë apo akordojë asnjë kuotë në asnjë lloj të aktiviteteve të tregëtisë me jashtë.

7.2 Nëse një dispozitë e tillë shprehimisht dhe qartë autorizon vendosjen, implementimin apo caktimin e kuotës e cila do të ishte në kundërshtim me paragrafin 7.1, kjo kuotë nuk do të vendoset apo implementohet nëse, sipas rrethanave të përcaktuara është praktikisht e mundëshme që të arrihet qëllimi i njëjtë, përmes detyrimit të pagesave shtesë të cilat janë të kalkuluara në mënyrë të arësyeshme, për arritjen e qëllimit mbrojtës të nivelit i cili është i barabartë për përdorimin e një kuote të tillë.

7.3 Nëse, në pajtim me këtë ligj, akti normativ vendos një kuotë të importit apo eksportit, që e cakton pjesëmarrjen e Kosovës në një kuotë të importit apo eksportit të vendosur nga një qeveri tjetër dhe nevoja për një leje importi apo leje eksporti vendoset në lidhje me implementimin apo akordimin e një kuote të tillë, autoriteti përkatës do të akordojë autorizime të tilla për të gjithë aplikantët e kualifikuar në bazë të kriterëve objektive, racionale dhe transparente. Kriteret e tilla nuk mund të vendosen apo të implementohen nëse si mbështetje kanë qëllimin diskriminues apo anti-konkurrenës. Kushtet të cilat aplikanti duhet t'i përmbushë për t'u kualifikuar për marrjen e një autorizimi të tillë duhet të jenë reale, të arësyeshme dhe transparente dhe nuk do të zbatohen nëse kanë për qëllim diskriminimin apo anti-konkurrencën.

7.4 Asnjë personi, apo ndërmarrje të cilës i është lejuar një kontingjent i kuotës për import apo eksport apo një leje që përfaqëson një akordim të tillë nuk i lejohet që ta bartë apo të lejojë që leja e dhënë të përdoret nga një person apo ndërmarrje tjetër.

#### Neni 8

#### Mosndikimi në legjislacionin e doganave

8.1 Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk do të interpretohet si cënim apo ndikim në legjislacionin e doganave të Kosovës.

8.2 Leja, certifikata apo autorizimi tjetër i lëshuar apo i dhënë në bazë të këtij ligji ose një akti normativ të nxjerr në pajtim me këtë ligj, nuk do të ndikojë në obligimin e asnjë personi apo ndërmarrje që të paguajë taksa, tarifa apo shuma tjera të cilat duhet të paguheshin sipas rregulloreve mbi eksportin dhe importin e mallrave.

### **Kapitulli 3**

### **Bazat e përgjithëshme për kufizimin e Aktiviteteve të Tregëtisë me Jashtë**

#### Neni 9

#### Implementimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

9.1 Nëse Kosova është e obliguar të implementojë dispozitën e ndonjë marrëveshje ndërkombëtare e cila qartë kërkon vendosjen e një mase restriktive e cila përndryshe do të ishte në kundërshtim me nenin 3, Qeveria mund të lëshojë, sipas autorizimit të këtij neni, një akt normativ i cili do të vendosë një masë të tillë.

9.2 Çdo masë kufizuese e vendosur kështu, duhet që plotësisht të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 4 dhe, deri në atë masën sa është në përputhje me përmbushjen e obligimit përkatës, do t'i nënshtrohet çfarëdo dispozite tjetër të zbatueshme të këtij ligji.

## **KAPITULLI 4** **MALLRAT E IMPORTUARA**

### **Pjesa 1**

#### **Rregullat themelore mbi mallrat e importuara**

##### **Neni 10**

###### **Trajtimi vendor i mallrave të importuara.**

Përveç nëse në mënyrë të veçantë parashihet ndryshe me këtë ligj apo me një akt normativ të autorizuar nga ky ligj, Kosova do tu jep mallrave që janë importuar tretmanin i cili nuk është më pak i favorshëm se tretmani i dhënë prodhimeve vendore të ngjashme; duke përfshirë, por pa u kufizuar në, tretmanin në lidhje me shkallën dhe shfrytëzimin e të gjitha taksave dhe tarifave tjera të brendëshme, dhe tretmanit që ndikon në shitjen, blerjen, transportimin, përpunimin, shpërndarjen apo shfrytëzimin e mallrave.

##### **Neni 11**

###### **Tretmani i kombit më të favorizuar**

11.1. Nëse është në fuqi një marrëveshje ndërkombëtare e dyanshme apo e shumanshme që ligji ndërkombëtar kërkon nga Kosova ta respektoj dhe marrëveshja e tillë e obligon që Kosovës ti ipet tretmani i kombit më të favorizuar për importimin e mallrave që kanë origjinë nga rajoni apo rajonet e jashtme, atëherë përveç kur në mënyrë të vacant parashihet ndryshe me këtë ligj ose aktin normativ të nxjerrë në bazë të këtij ligji, Kosovës do ti ipet tretmani i kombit më të favorizuar për importimin e mallrave të tilla.

11.2 Kur importimi i mallit lejohet në bazë të tretmanit të kombit më të favorizuar sipas nenit 11.1, Kosova do ti jep importit të mallit të tillë tretmanin i cili është i barabartë me tretmanin më të favorizuar të cilin Kosova ja jep çdo lloji të ngjashëm të mallit me origjinë nga çdo rajon i jashtëm. Për më tepër çdo përparësi, privilegj ose imunitet i dhënë nga Kosova, çdo malli që është importuar, do ti jepet drejtëpërdrejtë dhe në kushte të njejta çdo malli të ngjashëm që ka të drejtë në tretmanin e kombit më të favorizuar sipas nenit 11.

11.3. Gjatë caktimit të shkallës së veçantë të tretmanit të kombit më të favorizuar, të kërkuar sipas nenit 11.1 dhe 11.2, nuk do të merret parasysh asnjë favorizim i dhënë ndaj importimit të mallrave prej rajoneve të caktuara të jashtme nëse tretmani i favorizuar, i privilegjuar ose tjetër më i favorshëm kërkohet me ndonjë dispozitë obliguese të një

marrëveshje të shumanshme apo dyanshme të zonës së lirë doganore ose unionit doganor, ose me një marrëveshje të shumanshme ose të dyanshme të përkohshme që ka për qëllim mbështetjen dhe formimin e zonës së lirë tregëtare ose unionit doganor, të cilin ligji ndërkombëtar kërkon që Kosova ta respektoj.

11.4 Asgjë në nenin 11.1 apo 11.2 nuk do të interpretohet si ndalim ose dhënie e tretmanit të kombit më të favorizuar për importin e mallrave që kanë origjinë nga rajonet e jashtme të cilat nuk përfshihen në ndonjë marrëveshje të shumanshme apo të dyanshme.

## Pjesa 2

### Kërkesat dhe standardet teknike për mallërat e importuara

#### Neni 12

#### Kushtet sanitare dhe fitosanitare

12.1. Qeveria është e autorizimur të nxjerrë një apo më shumë akte normative në bazë të këtij ligji duke themeluar, ose autorizuar një apo më shumë autoritete publike të caktuara që, të përcaktojnë, (i) kushtet sanitare dhe /ose fitosanitare të cilat llojet e caktuara të mallrave duhet t'i plotësojnë dhe (ii) procedurat objektive dhe konforme të vlerësimit për sigurimin e përputhshmërisë së mallrave gjegjëse me kushtet përkatëse.

12.2 Të gjitha kushtet sanitare dhe fitosanitare dhe procedurat e vlerësimit të përputhshmërisë, metodat e aplikimit të tyre dhe lista e llojit/kategorisë së mallrave ndaj të cilave ato do të zbatohen, duhet të jenë të përgatitura, të miratuara dhe të zbatuara në atë mënyrë që që, në bazë të parimeve të mbështetura shkencore të jenë qartë në lidhje me dhe të domosdoshme për arritjen e një apo më shumë qëllimeve vijuese: (i) mbrojtja e jetës së njerëzve apo kafshëve ose shëndetit nga rreziqet që dalin nga aditivët, kontaminimet, materiet toksike, organizmat që bartin ose shkaktojnë sëmundjet në ushqim; (ii) mbrojtja e jetës ose shëndetit prej sëmundjeve që bartin kafshët ose bimët; (iii) mbrojtja e jetës dhe shëndetit të kafshëve dhe bimëve nga insektet e dëmshme, sëmundjejt ose organizmat sëmundje-shkakëtues apo sëmundje-bartës; ose (iv) parandalimi ose kufizimi i demit që mund t'i shkatohet Kosovës nga hyrja e stabilimenteve ose shpërndarja e insekteve dhe (iv) parandalimi apo kufizimi i dëmtimit të Kosovës nga hyrja, vendosja apo shpërndarja e insekteve të dëmshme.

12.3 Asnjë këkesë sanitare ose fitosanitare nuk do të jetë më shumë treg-kufizuese se standardi relevant ndërkombëtarisht gjerësisht i njohur ose direktiva relevante dhe/ose rekomandimi i nxjerrë nga organizata e njohur ndërkombëtare. Pavarësisht nga ajo që u theksua më lart mund të caktohet kusht më restriktiv sanitar apo fitosanitar, por vetëm nëse kushti i tillë qartë dhe objektivisht mund të arsyetohet me metodën e mbështetur shkencore që provon se kushti më restriktiv është i nevojshëm në mënyrë të domosdoshme për arritjen e qëllimit të përcaktuar në nenin 11.2 më lartë.

12.4. Çdo kusht sanitar apo fitosanitar, dhe procedurat relevante të përputhshmërisë, vlejné njësoj për të gjitha mallrat pa marrë parasysh origjinën; me kusht që sidoqoftë kushti i tillë ose procedura e vlerësimit të përputhshmërisë mund të bëj diskriminim të arsyeshëm në mesin e mallrave që kanë origjinë nga rajonet e ndryshme, por vetëm nëse arsyetimi për diskriminim të tillë është i qartë, objektiv dhe ndërkombëtarisht i pranuar.

12.5 Përgatitja, miratimi dhe implementimi i kushteve të tilla sanitare dhe fitosanitare, procedurat e vlerësimit të përshtatshmërisë dhe listat e llojeve/kategorive të mallrave ndaj të cilave ato zbatohen, (i) nuk do të kryhen me qëllim të krijimit të, ose në mënyrë që të kenë ndikim e pengesë të panevojshme të tregëtisë; dhe (ii) përndryshe do të përgatiten, miratohen dhe implementohen, aq sa është e mundëshme, në pajtim me rekomandimet dhe kërkesat relevante të Marrëveshjes së OBT-së Mbi Zbatimin e Masave Sanitare dhe Fitosanitare.

### Neni 13

#### Normat Teknike

13.1 Qeveria është e autorizuar të nxjerrë një apo më shumë akte normative në bazë të këtij ligji, duke themeluar apo autorizuar një apo më shumë autoritete publike të caktuara për të vendosur normat teknike që përcaktojnë , (i) llojet apo kategoritë mallrave duhet t'i plotësojnë dhe (ii) procedurat e drejta dhe objective të vlerësimit të përputhshmërisë për sigurimin e pajtueshmërisë së mallrave gjegjëse me normat përkatëse.

13.2 Të gjitha normat teknike, procedurat e vlerësimit të përputhshmërisë, metodat e tyre të aplikimit dhe lista e llojeve/kategorive të mallërave ndaj të cilave ato aplikohen, duhet të jenë të përgatitura, miratuara dhe të aplikuara në mënyrën që është e qartë dhe e domosdoshme për arritjen e një apo më apo më shumë qëllimeve vijuese:(i) mbrojtja e jetës, shëndetit dhe sigurisë së njerëzve; (ii) mbrojtja e jetës dhe shëndetit të kafshëve dhe bimëve; (iii) mbrojtja e ambientit; apo (iv) parandalimi i praktikave mashtruese; me kusht që, *sidoqoftë*, çdo mase që ka qëllimin e përcaktuar në nenin 12.2, të mos jetë brenda fushveprimit të nenit 13.

13.3 Përgatitja, miratimi dhe implementimi i normave teknike, procedurave gjegjëse të vlerësimit të përputhshmërisë (në relacion me këto rregulla) dhe listat e llojeve/kategorive të mallrave ndaj të cilave zbatohen, (i) nuk duhet të kryhen me qëllim të krijimit ose në mënyrën që të ndikojnë në pengesat e panevojshme të tregëtisë, (ii) nuk do të kenë karakter më shumë kufizues të tregëtisë sesa që me të drejtë është e nevojshme për të arritur qëllimin për të cilin ato janë themeluar, (iii) do të vlejné njësoj për të gjitha mallrat e ngjashme pa marrë parasysh origjinën, dhe (iv) përndryshe do të përgatiten, miratohen dhe implementohen, aq sa është e mundur në pajtim me kërkesat relevante të Marrëveshjes së OBT mbi Barrierat Teknike ndaj Tregëtisë.

13.4 Çdo normë e tillë teknike do të bazohet në standardin relevant ndërkombëtar ose pjesën relevante të tij, nese standardi i tillë ekziston ose zhvillimi i tij është në një fazë të avancuar; *me kusht që sidoqoftë*, nese në bazë të dëshmive apo parimeve qenësore shkencore mund të provohet se normat teknike të bazuara në standardin e tillë nuk janë

duke arritur ose nuk do të arrijnë, në një mënyrë efektive dhe të përshtatshme, qëllimin për të cilin ka qenë ose do të krijohet. Norma e tillë teknike mund të shmanget prej atij standardi deri në shkallën e pranueshme të nevojshme për arritjen e qëllimit të tillë.

#### Neni 14 Standardet e prodhimit

14.1 Çdo autoritet publik ose ndërmarrje tjetër që vepron në territorin e Kosovës, që është e inkuadruar apo ka përgjegjësi për përgatitjen, miratimin dhe implementimin e standardeve të prodhimit (organi vendor për caktimin e standardeve) do të përputhet me Kodin e Praktikës së Mirë për Përgatitjen, Miratimin dhe Implementimin e Standardeve në Aneksin 3 të Marrëveshjes mbi Pengesat Teknike ndaj Tregëtisë të OBT-së, si dhe ndryshimet e plotësimet e kohë-paskohshme të saj.

14.2 Qeveria do të nxjerr akt normativ që përmban dispozita dhe kërkesa racionale që kanë të bëjnë me përputhshmërinë e tillë nga organet vendore të caktimit të standardeve. Nëse ndonjë organ vendas i caktimit të standardeve ka të drejtat e antarsisë dhe/ose ndikim në programin regjional apo ndërkombëtar të caktimit të standardeve, Qeveria mund të nxjerr akt normativ që përmbanë kërkesat që sigurojnë se organi i tillë vendor për caktimin e standardeve të ushtrojnë çdo të drejtë të tillë dhe/ose ndikim në mënyrën që shpie kah nxitja e organit të tillë rajonal/ndërkombëtar të pranojë dhe veprojnë në pajtim me Kodin e përcaktuar në paragrafin 14.1.

14.3 Përgatitja, miratimi dhe implementimi i standardeve të prodhimit, procedurat gjegjëse të vlerësimit të përputhshmërisë dhe listat e llojeve/kategorive të mallrave për të cilat ato vlejnë (i) nuk do të kryhen me qëllim të krijimit ose në një mënyrë që do të ketë ndikim në mënyrën që krijon pengesa të panevojshme për tregëtinë; (ii) nuk do të ketë më tepër karakter kufizues të tregëtisë se sa është e nevojshme për të arritur qëllimin për të cilin ato janë themeluar, (iii) do të aplikohen njësoj për të gjitha llojet e ngjashme të mallrave pa marrë parasyshë origjinën, dhe (iv) përndryshe do të përgatiten, miratohen dhe implementohen aq sa është e mundur, në pajtim me rekomandimet dhe kërkesat e Marrëveshjes së OBT-së Mbi Pengesat Teknike mbi Tregëtinë.

#### Pjesa 3 Lejet e importit

##### Neni 15 Rregull e përgjithshme: nuk kërkohet leje për import

Me përjashtim të mallrave të përcaktuara në listën e kontrollimit të importeve në pajtim me nenin 16 më poshtë, për importin e mallrave në Kosovë nuk kërkohet leje ose ndonjë licencë e llojit tjetër nga cilido autoritet publik.

Neni 16  
Lista e importeve të kontrolluara

Qeveria është e autorizuar të nxjerrë listen e mallrave të quajtur “ Lista e importeve të kontrolluara”. Lista e tillë do të specifikojë ato lloje dhe/ato kategori të mallrave për importimin e të cilave është e nevojshme leja. Qeveria mund të përfshijë në një listë të tillë lloje apo kategori të mallrave vetëm nëse ka arësye të qarta themelore dhe të vërteta të cilat arësyojnë domosdoshmërinë për kontrollimin e importimit të atyre llojeve apo cilësive të mallrave, në mënyrë që esencialisht të bëhet përparim në arritjen e qëllimeve vijuese:

- (a) të mbroj nga rreziqet e mundëshme ambientin, ose jetën e shëndetit të njerëzve, bimëve dhe kafshëve;
- (b) të mbrojë rendin dhe moralin publik;
- (c) të parandalojë shkeljen e të drejtës së pronës intelektuale;
- (d) të mbrojë konsumatorët nga praktikat rrejshme dhe mashtruese;
- (e) të implementojë dispozitën e një marrëveshje ndërkombëtare e cila e obligon Kosovën ta zbatojë;
- (f) të implementojë kufizimet mbi transaksionet e importimeve që kanë të bëjnë me arin;
- (g) të sigurojë implementimin e duhur dhe caktimin e barabartë, në mesin e furnizuesve dhe /ose importuesve, të kuotave të importit të vendosura nga Kosova në importet e mallrave të caktuara, dhe;
- (h) të siguroj në pajtim me nevojat e Kosovës, furnizimin më të mirë, dhe shpërndarjen e barabartë të mallrave të nevojës së parë që janë
  - (i) dëshmuar të jenë të rrallë në tregjet botërore ose në Kosovë dhe
  - (ii) që i nënshtrohet kontrolleve të eksportit qeveritar në rajonin e jashtëm të origjinës së mallit të tillë.

Neni 17  
Përcaktimi i kritereve të kërkuara për marrjen e lejes së importit

17.1 Për çdo lloj apo kategori të mallërave, të përfshirë në listën e kontrollit të importit, Qeveria do të themeloj ose kërkoj nga një apo më shumë autoritete publike të përcaktojë, me një akt normativ kriteret që duhet të plotësohen nga aplikuesi me qëllim të marrjes së lejes për importin e mallit të tillë.

17.2 Të gjitha kriteret e tilla do të jenë transparente, të qarta dhe qenësish të domosdoshme për arritjen e qëllimit të theksuar në përfshirjen e llojit të tillë apo kategorisë së mallit në listen e konrtollit të importit.

17.3 Të gjitha kriteret e tilla do të jenë jodiskriminuese; sidoqoftë, kur është qartë dhe realisht e nevojshme për arritjen e qëllimit përkatës mund të përcaktohet që leja e importit për llojin e veçantë të kategorisë ose llojit të mallit do t'i jepet vetëm poseduesit të licencës së veprimtarisë relevante; me kusht që, sidoqoftë, nga një aplikues i tillë nuk do të kërkohet posedimi i licencës së tillë të veprimtarisë, nëse licenca e tillë nuk kërkohet për tu marrë drejtpërdrejtë me mallra kompetitiv konkurues me origjinë vendore.

17.4 As qeveria dhe asnjë autoritet tjetër publik nuk mund të përdorë asnjë dispozitë të Pjesës 3-të përveq nenit 18, që të kufizoj importimin e çdo lloji apo kategorie të mallit deri sa të mos jetë kërkuar kriteri i lejes së importit dhe procedura për lëshimin e saj të mos jetë përgatitur, plotësuar dhe zbatuar tërësisht..

### Neni 18 Importet e ndaluara

18.1 Nëse kategoria apo lloj i mallit të përfshirë në Listën mbi Kontrollimin të Importeve për arritjen e qëllimit të përcaktuar në pikat (a)-(e) të nenit 16, dhe qëllimi i tillë në mënyrë të arësyeshme mund të arrihet vetëm me ndalimin e importit të një malli të kategorisë apo llojit të tillë, Qeveria mund të ndalojë importimin e këtij malli.

18.2 Nëse importimi i një kategorie apo lloji të mallit është i ndaluar, asnjë person, ndërmarrje kompani publike nuk do ti lejohet që të importojë, të mirret apo të trajtojë një mall të tillë. Importim i një malli të tillë nga autoriteti publik mund të lejohet nëse importimi i tillë (i) është i qartë dhe i domosdoshëm për arritjen e funksionit publik legjitim dhe (ii) nuk do të përdoret apo përfshihet në asnjë mënyrë në zhvillimin, ose do të varet nga cilido aktivitet komercial apo biznesor ekonomik.

### Neni 19 Kufizimet në shfrytëzimin apo disponimin e mallrave të importuara

Nëse qartë është e nevojshme për arritjen e qëllimit të përcaktuar, një leje importi mund të përmabajë kushte që kufizojnë përdorimin ose disponimin tjetër që mund ti bëhet në lidhje me mallin e importuar.

### Neni 20 Lejet për transportet e shumfishta

Leja e importit, deri në shkallën që është në përputhje me qëllimin e theksuar në përfshirjen e mallit të cakuar në listen e importeve të kontrolluara i lejon poseduesit të saj të importojë sasinë e përcaktuar sakt të mallrave përkatës në çdo kohë, dhe në transporte të shumfishta, gjatë një periudhe të caktuar kohe që nuk kalon një vit.



## Neni 21

### Importimet jokomerciale dhe përjashtimet tjera

21.1 Kur realisht nuk rrezikohet qëllimi theksuar i përfshirjes së mallrave të kategorisë apo llojit në listën e importeve të kontrolluara, Qeveria mund të nxjerr akt normativ që përjashton importet e mallrave të tilla në sasi të vogla, nën supozimet jokomerciale nga kërkesat që përndryshe zbatohen me lejet e importit. Çdo akt i tillë normativ do të përcaktojë kriteret transparente, objektive dhe jodiskriminuese që duhet të plotësohen për kualifikimin e një përjashtimi të tillë të përcaktuar sipas këtij paragrafi.

21.2 Nëse lloji dhe kategoria e mallit është në listën e kontrollit të importit, Qeveria mund të nxjerr akt normativ, që përmban dispozita të cilat lejojnë importimin e mallit gjegjësisht të veprave pa ndonjë leje importi, nën këto kushte: (i) kur qartë theksohet se importi i mallit përkatës nuk do të futet në tregun e zakonshëm të Kosovës ose (ii) kur qëllimi gjegjësisht i caktuar në nenin 16, mund të mbrohet njësoj me disa mjete tjera efektive. Ky paragraf posaqerisht vlen për mallrat të cilat hyjnë në zonën e lire, mallrat e importuara sipas procedurave të veçanta doganore për përpunim, mallrat e importuara sipas obligacioneve doganore.

## Neni 22

### Përputhshmëria me kërkesat e OBT-së.

Përgatitja, miratimi dhe implementimi i të gjitha kërkesave për leje importi, kriteret dhe procedurat do të jenë në përputhshëri me dispozitat e marrëveshjes së OBT-së Mbi Procedurat e Licensimit të Importimeve që merren me licensim jo-automatik.

## Pjesa 4

### Masat e veçanta tregëtare

## Neni 23

### Tarifat tatimore anti-damping

23.1 Qeveria është e autorizuar të përgatisë, miratojë dhe implementojë një akt normativ me të cilin parasheh vendosjen e tatimeve anti-damping mbi ose në importet e kategorisë apo llojit të vacant të mallit që kanë origjinë nga një rajon i vacant i jashtëm, nëse- pas hetimit të bazuar procedural – vërtetohet se (I) mallrat e tillë nga rajoni i tillë janë duke u futur në tregëtinë e Kosovës në vlerën që është më e vogël se vlera e tyre normale, dhe (ii) veprimtaria e tillë është duke shkaktuar apo kërcënon të shkaktojë dëm material industrisë së themeluar vendore që prodhon mall të ngjashëm, ose që vonon realisht themelimin e një industrie të tillë vendore.

23.2 Akti normativ i lejuar me paragrafin e paraprak do të përgatitet, miratohet dhe implementohet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e Marrëveshjes mbi Implementimin e nenit VI të Marrëveshjes së Përgjithëshme mbi Tarifat dhe Tregëtinë të OBT-së të vitit 1994.

23.3 Qeveria dhe asnjë autoritet publik nuk mund të vendosë taksa doganore anti-damping apo masa tjera anti-damping ndaj cilitdo mall të importuar gjersa akti normativ të mos jetë përgatitur, miratuar dhe implementuar në pajtueshmëri të plotë me këtë nen.

#### Neni 24 Masat kundërvepruese

24.1 Qeveria është e autorizuar të përgatisë, adoptojë dhe të implementojë një akt normativ i cili e vendos imponimin e taksave kundërvepruese mbi një lloj apo kategori të veçantë të mallit e cila e ka prejardhjen nga një rajon i veçantë i jashtëm, nëse – pas një procedure të bazuar hetimore, vërtetohet se (i) mallrat e tilla nga një rajon i tillë po përfitojnë nga një subvencion i cili ose është i dënueshëm ose është i ndaluar sipas Marrëveshjes e OBT-së mbi Subvencionet dhe Masat Kundërvepruese, dhe (ii) si pasojë e një përparësie të tillë, importet e mallrave të tilla janë duke shkaktuar apo rrezikojnë të shkaktojnë dëme të vërteta materiale industrisë vendore e cila prodhon mallra të ngjajshme, apo që vonojnë realisht themelimin dhe ngritjen e një industrie të tillë vendore.

24.2 Akti normativ i paraparë me paragrafin paraprak do të përgatitet, miratohet dhe implementohet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e Marrëveshjes mbi Subvencionet dhe Masat Kundërvepruese të OBT-së.

24.3 As Qeveria dhe asnjë autoritet tjetër publik nuk mund të imponojë masa kundërvepruese në asnjë mall të importuar derisa një akt normativ i cili është në pajtueshmëri të plotë me këtë nen të jetë përgatitur, miratuar dhe implementuar plotësisht.

#### Neni 25 Masat e mbrojtjes

25.1 Qeveria është e autorizuar të përgatisë, miratojë dhe implementojë një akt normativ i cili vendos imponimin e taksave mbrojtëse mbi të gjitha importimet e një lloji apo kategorie të veçantë të mallit, pa marrë parasysh prejardhjen, nëse - pas ndërmarrjes së procedurave hetimore, caktohet se (i) mallrat e tilla janë duke u importuar në sasi të mëdha dhe (ii) sasi të tilla të mëdha janë duke shkakëtuar apo rrezikojnë që të shkakëtojnë dëm të vërtetë industrisë vendore e cila mirret me prodhimin e mallrave të ngjajshme apo mallrave drejtpërdrejt konkurruese.

25.2 Akti normativ i paraparë me paragrafin paraprak do të përgatitet, miratohet dhe implementohet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e Marrëveshjes së OBT-së mbi Mbrojtjen.

25.3 Asnjë masë mbrojtëse nuk mund të imponohet në asnjë mall të importuar derisa të përgatitet, miratohet dhe implementohet një akt normativ i cili është në pajtueshmëri të plotë me këtë nen.

**Pjesa 5**  
**Masat tjera që ndikojnë në mallrat e importuara**

**Neni 26**  
**Masat kufitare për mbrojtjen e pronës intelektuale në kufi**

26.1 Qeveria do të përgatisë, në pajtim me këtë dispozitë, aktin normativ i cili mundëson ndërmarrjen e masave detyruese ligjore kufitare për mbrojtjen e të drejtave të një personi apo ndërmarrje në apo për pronat intelektuale kundër importimit të mallrave që shkelin të drejtat e tilla.

26.2 Akti normativ që kërkohet me paragrafin paraprak do të parashohë procedurën e arsyeshme që bartësit e të drejtave të tilla të mund të arrijnë bashkëpunimin me MTI-së dhe aturitetet doganore të Kosovës për zbatimin e të drejtave të tilla në kufi. Masat e tilla detyruese gjithashtu do t'i autorizojnë autoritetet doganore t'i konfiskojnë dhe të disponojnë me mallrat të cilat i shkelin të drejtat e tilla.

26.3 Së paku, një akt i tillë normativ do të parashohë procedurën në lidhje me falsifikimin e produkteve me shenjë tregëtare të falsifikuar dhe produktet e falsifikuar të së drejtës së autorit.

26.4 Një akt i tillë normativë do të përcaktojë mbrojtjen përkatëse themelore që siguron se asnjë person, ndërmarrje apo autoritet publik nuk do të keqpërdorë tregëtinë e ligjshme.

26.5 Akti normativ i autorizuar nga paragrafet paraprake do të përgatitet, miratohet dhe implementohet në pajtueshmëri me kushtet e Marrëveshjes së OBT-ë mbi aspektet gjegjëse të tregëtisë së të drejtave të pronës intelektuale.

**Kapitulli 5**  
**Mallrat e eksportuara**

**Pjesa 1**  
**Rregullat themelore mbi eksportimin e mallrave**

**Neni 27**  
**Tretmani i kombit më të favorizuar**

27.1 Nëse është në fuqi një marrëveshje ndërkombëtare e dyanëshme ose e shumëanëshme që ligji ndërkombëtar kërkon që Kosova ta respektojë, dhe marrëveshja e tillë obligon që Kosovës t'i ipet tretmani i kombit më të favorizuar për eksportimin e mallrave të destinuara për një rajon apo rajone të jashtme të veçanta, atëherë, përveq kur shprehimisht parashihet ndryshe me këtë ligj ase aktin tjetër normativ të lejuar me këtë ligj, Kosovës do t'i jipet tretman i kombit më të favorizuar për eksportet e tilla.

27.2 Kur eksportimi i mallit autorizohet nga tretmani i kombit më të favorizuar sipas paragrafit 28.1, Kosovës do t'i ipet një tretman i tillë eksporti i cili është i barabartë me tretmanin e kombit më të favorizuar që i ipet Kosovës për cilindo mall të tillë të ngashëm, pa marrë parasysh destinimin. Kjo kërkesë shtrihet gjer në vendosjen dhe aplikimin e- (i) taksave të eksportit, tarifave dhe taksave të çfarëdo lloji të vendosura mbi apo në lidhje me eksportin e tillë, (ii) mënyrës së vjeljes së taksave, detyrimeve dhe tarifave të tilla dhe (iii) rregullave e formaliteteve që duhet të ndiqen në lidhje me eksportin e tillë.

27.3 Me rastin e caktimit të shkallës së veçantë të tretmanit kombit më të favorizuar të kërkuar me paragrafet 27.1 dhe 27.2, nuk do të mirret në konsideratë asnjë tretman më i preferuar apo më i privilegjuar i cili është caktuar nga Kosova për eksportimin e mallrave në rajonet e jashtme derisa tretmani i tillë i preferuar, privilegjuar, apo i favorizuar kërkohet nga një dispozitë obligative e një marrëveshje të dyanëshme apo të shumëanëshme e rajoneve të tregut të lirë apo unionit të doganave, apo të një marrëveshje të dyanëshme apo të shumëanëshme të përkohshme që ka për qëllim mbështetjen dhe formimin e rajoneve të tilla të lira apo unionioneve doganore, të cilën ligji ndërkombtar kërkon nga Kosova që ta respektojë.

27.4 Asgjë në paragrafin 27.1 apo 27.2 nuk do të interpretohet si pengesë për dhënien e tretmanit të kombit më të favorizuar për eksportet e destinuar për rajonet e jashtme të cilat nuk janë të mbuluara nga një marrëveshje e dyanëshme apo e shumëanëshme.

## **Pjesa 2** **Standardet dhe kërkesat teknike** **për mallrat e eksportuara**

### **Neni 28** **Kërkesat sanitare dhe fitosanitare** **Normat teknike dhe standardet e prodhimeve**

28.1 Deri në masën që është e arsyeshme që të sigurohet se mallrat që eksportohen nga Kosova nuk janë të një cilësie të dobët, Qeveria mund të nxjerrë një apo më shumë akte normative të cilat do të kërkojnë që disa lloje apo kategori të mallrave të caktuara të përcillen me certificate që dëshmon se ato janë në pajtim me normat relevante teknike të caktuara, kushtet e caktuara sanitare, fitosanitare dhe standarde të prodhimeve.

28.2 Çdo kërkesë e përcaktuar në pajtim me paragrafin paraprak do të vlejë në mënyrë të njëjtë për të gjithë prodhuesit dhe eksportuesit përkatës.

28.3 Veçanërisht, asnjë kërkesë e tillë nuk do të krijohet, miratohet apo implementohet në mënyrë që të bëjë diskriminim në mesin e eksporteve duke u bazuar në destinacionin e mallrave.

**Pjesa 3**  
**Lejet për eksport**

**Neni 29**

**Rregull e përgjithëshme: nuk kërkohet leje eksporti**

Me përjashtim të mallrave të përcaktuara në listen e kontrollit të eksportit të përcaktuar sipas nenit 30 më poshtë, për eksportimin e mallrave nga Kosova nuk do të kërkohet leje, licensë apo autorizim nga cilido autoritet publik.

**Neni 30**

**Lista e kontrollit të eksportit.**

Qeveria do të ketë autoritetin që të krijojë listen e mallrave të quajtur “Lista e kontrollit të eksporteve”. Lista e tillë do të përcaktojë sakt ato lloje apo kategori të mallrave për eksportin e të cilave kërkohet leje. Qeveria mund të përfshijë në listen e tillë llojin apo kategorin e mallit vetëm nëse ka arsye të qarta, reale dhe objektive që dëshmojnë se është e nevojshme kontrolli i eksportit të mallrave të kategorisë apo llijit të tillë, me qëllim që realisht të avancojë arritjen e njëres nga qëllimet vijuese:

- (a) të ndalojë shkeljet e të drejtave mbi pronën intelektuale;
- (b) të zbatojë kufizime mbi transaksionet e eksporteve që kanë të bëjnë me arin;
- (c) të mbrojë llojët e rrezikuara të bimëve dhe kafshëve;
- (d) të mbrojë artikujt që konsiderohen si thesarë kombëtarë dhe që kanë vlerë të njohur dhe të rëndësishme artistike, historike apo arkeologjike;
- (e) të zbatojë dispozitat obligative të një marrëveshje ndërkombëtare;
- (f) të zbatojë masat që janë në mënyrë të qartë dhe qenësisht të domosdoshme për konservimin e burimeve të shterrueshme natyrore, por vetëm nëse këto masa shoqërohen me kontrollin e rëndësishëm qeveritar ndaj prodhimeve të vendit dhe konsumimit të këtyre resuseve;
- (g) të zbatojë masa të përkohëshme me qëllimin të sigurimit të furnizimit adekuat minimal të tregun e vendit me artikuj ushqimor bazik dhe themelorë ose mallërave tjera vitale; sidoqoftë, kufizimet e eksportit për qëllime të tilla do të lejohen vetëm në rastet kur provohet në mënyrë të qartë se masat tjera të mundëshme janë joadekuate ose praktike; ose
- (h) të sigurojë zbatimin e duhur dhe caktimin e barabartë në mes të eksportuesve të kontigjenteve të vendosura nga shteti i huaj ose rajoni i jashtëm në importet e mallërave të tilla.

### Neni 31

#### Kriteret e nevojshme për marrjen e lejes së eksportit.

31.1 Për çdo lloj apo kategori të mallit të përfshirë në listën e eksporeve të kontrolluara, Qeveria do të themelojë ose kërkojë nga një apo më shumë autoritete të emëruara shtetërore që të vendosin, kriteret që duhet të përmbushen nga aplikuesi për të marrë një leje eksporti për një mall të tillë.

31.2 Të gjitha kriteriet e tilla do të jenë jo-diskriminuese, sidoqoftë, kur është qartë dhe realisht e nevojshme për arritjen e qëllimeve përkatëse mund të përcaktohet qartë që leja e eksportit për llojin apo kategorinë e veçantë të mallit do t'i ipepet vetëm poseduesit të licenses relevante të veprimtarisë; me kusht që, sidoqoftë, nga aplikuesi nuk do të kërkohej të posedojë një license veprimtarie nëse liçensa e tillë nuk është e nevojshme për punë të ngjashme ose drejtpërdrejtë konkurente të mallrave me origjinë vendore.

31.3 Të gjitha kriteriet e tilla do të jenë transparente dhe qartë e qenësisht të domosdoshme për arritjen e qëllimeve të theksuara për përfshirjen e llojit apo kategorisë së tillë të mallit në listën e eksporteve që duhet kontrolluar.

31.4 Qeveria nuk mund të përdorë asnjërën nga dispozitat e kësaj pjese (Pjesa 3) për kufizimin e eksportit të llojit apo kategorisë përkatëse të mallit përderisa procedura e nxjerrjes dhe kriteret e kërkuara të lejes së eksportit të mos përgatiten, miratohen dhe plotësisht të zbatohen.

### Neni 32

#### Eksportet e Ndaluar

32.1 Nëse një lloj apo kategori e mallrave është përfshirë në listën e eksporteve të kontrolluara me qëllim të arritjes së qëllimit të përcaktuar me pikat e prej(a) – (g) të nenit 30, dhe një qëllim i tillë mundet që të arrihet në mënyrë të arsyeshme me ndalimin e eksportit të mallit të llojit apo kategorisë së tillë të mallit, Qeveria mundet shprehimisht të ndalojë eksportin e tillë.

32.2 Nëse eksporti i një lloji apo kategori të mallit është i ndaluar – qoftë parimisht ose të një shteti apo rajon i caktuar sakt – asnjë person, ndërmarrje apo kompani publike nuk do të lejohet të eksportoje mallra të tilla. Eksporti i mallrave të tilla nga autoriteti publik mund të lejohet vetëm nëse eksporti i tillë (i) është qartë dhe qenësisht i domosdoshëm për autoritetin e tillë publik të kryejë funksionin e tij legjitim publik dhe (ii) nuk bëhet në mbështetje të ndonjë veprimtarie ekonomike, biznesi apo komercial.

### Neni 33

#### Kufizimet në përdorimin dhe disponimin e mallrave të eksportuara

Nëse qartë është e nevojshme arritja e qëllimit përkatës, leja e eksportit mund të përmbajë kushtet që kufizojnë shfrytëzimin dhe disponimin tjetër që mund të bëhet ndaj mallrave të

eksportuara përkatëse dhe të kërkojë lejen e eksportit për garantimin se kushtet e tilla do të plotësohen.

#### Neni 34

##### Eksporti i shërbimeve dhe informatave

Nëse është qartë e nevojshme dhe e domosdoshme, për arritjen e qëllimit të përcaktuar në pikat (a) të nenit 30, Qeveria mund të vendosë masa kufizuese mbi ofrimin e shërbimeve dhe informative ndaj rezidentëve dhe jorezidentëve.

#### Neni 35

##### Lejet e shumfishta të transportit

Një leje transporti, gjer në shkallën që është në përputhje me qëllimin e theksuar me përfshirjen e mallit përkatës në listen e kontrollit të eksportit, do të lejoj poseduesit të saj të eksportoj kuantitetin e përcaktuar qartë të mallit përkatës në çdo kohë dhe në dërgesa të shumfishta brenda një periudhe të caktuar kohore që nuk kalon një vit.

#### Neni 36

##### Eksportet jokomerciale dhe përjashtimet tjera

Kur realisht nuk rrezikon qëllimin e theksuar në përfshirjen e mallrave të llojit apo kategorisë në listen e kontrollit të eksportit, Qeveria mund të nxjerr një akt normativ me të cilin përjashton kushtet e lejes së eksportit ndaj mallrave të tilla në sasi të vogla, nën supozimin jokomercial të eksporteve për të cilat përndryshe leja e eksportit do të ishte e nevojshme. Çdo akt i tillë normativ do të përcaktoj kriterin transparent, objektiv dhe jodiskriminues që duhet të plotësohet për tu kualifikur për një përjashtim të tillë të përcaktuar me këtë paragraf.

### **Pjesa 4**

#### **Masat tjera që ndikojnë në mallrat e eksportuara**

#### Neni 37

##### Masat kufitare të pronës intelektuale

37.1. Qeveria është e autorizuar të xjerr, në bazë të këtij neni (37) një akt normativ i cili mundëson zbatimin e masave mbrojtëse në kufi me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të një personi apo ndërmarrje të pronës intelektuale kundër eksportit që i shkel këto të drejta.

37.2. Akti normativ i nxjerr në përputhje me paragrafin paaparak do të sigurojë procedurën e arësyeshme të cilën bartësi i të drejtës së tillë mund ta përdorë për arritjen e bashkëpunimit midis të MIT dhe organeve doganore të Kosovës për zbatimin e këtyre të drejtave në kufi. Masat e këtilla shtrënguese poashtu lejojnë organet doganore të disponojnë dhe konfiskojnë mallrat që i shkelin të drejtat e tilla.

37.3. Të paktën, një akt i tillë normativ do të parashohë procedurën në lidhje me mallrat me markë tregëtare të falsifikuarur dhe prodhimet e të drejtës së autorit të plagjetuara.

37.4. Akti i tillë normativ do të parashohë mbrojtjen procedurale adekuate që siguron se asnjë person, ndërmarrje ose autoritet publik nuk do ta pengojë tregëtinë e ligjshme.

37.5. Akti normativ i nxjerrë në përputhje me paragrafet paraprake do të përgatitet, adoptohet dhe zbatohet në pajtim me kërkesat e Konventës së OBT-së mbi aspektet përkatëse të tregëtisë të të drejtave të pronës intelektuale.

Neni 38  
I rezervuar

**Kapitulli 6**  
**E drejta për import dhe eksport**

Neni 39  
Eksportet dhe importet jokomerciale

39.1 Çdo banor rezident dhe çdo banor jorezident ka të drejtë që të importojë dhe eksportojë, për qëllime jokomerciale, mallra që nuk i nënshtrohen kërkesës për leje.

39.2 Qeveria mundet sipas nenit 21 të përcaktojë kushtet që rregullojnë aftësinë e rezidentëve dhe jorezidentëve të importojnë pa leje për qëllime jokomerciale mallin i cili përndryshe i nënshtrohet kushteve për leje importi.

39.3. Qevria mund të përcaktojë sipas nenit 37, kushte të cilat rregullojnë aftësinë e rezidentëve dhe jorezidentëve që të eksportojnë pa leje, për qëllime jokomerciale, mallin i cili përndryshe i nënshtrohet kushteve për leje eksporti.

Neni 40  
Importet dhe eksportet komerciale.

40.1 Një rezident i cili është regjistruar në regjistrin komercial apo biznesor të Kosovës dhe që ka të drejtë të inkuadrohet në veprimtari komerciale, biznesi apo komerciale do të ketë automatikisht të drejtë që të importojë apo eksportojë mallra në sasi komerciale dhe për qëllime komerciale.

40.2 E drejta e përcaktuar në paragrafin paraprak varet nga /dhe do të ushtrohet në pajtim me çdo masë kufizuese e cila është themeluar në bazë të autorizimit të këtij ligji. Me përjashtim të masave restriktive të lejuara me këtë ligj asnjë akt normativ nuk do të vendosë, dhe asnjë autoritet publik nuk do të përgatisë, miratojë e implementojë asnjë kërkesë apo procedure që pengon të drejtën e vendosur me paragrafin paraprak ose vendosjen e kushteve për ushtrimin e saj.



40.3 Banorët jorezident nuk do të kenë të drejtë të importojnë dhe eksportojnë mallra në sasi komerciale apo për qëllime komerciale.

40.4 Një rezident i cili nuk është regjistruar në regjistrin komercial apo biznesor ose që nuk ka atë të drejtë të mirret me aktivitete komerciale, biznesore apo ekonomike në Kosovë, nuk do të ketë të drejtë që të importojë apo eksportojë mallra në sasi komerciale apo për qëllime komerciale.

## **Kapitulli 7** **Dispozitat plotësuese**

### **Neni 41** **Transaksionet e arit**

Ky ligj nuk do të pengojë mundësinë e Qeverinësë që të rregullojë lirisht veprimtarinë e tregëtisë me jashtë duke përfshirë arin.

### **Neni 42** **Transaksionet e shërbimeve**

Transaksionet që ngërthejnë ofrimin e shërbimeve nga rezidentët ndaj jorezidentëve ose nga jorezidentët ndaj rezidentëve do të jenë të lira nga masat restriktive, përveç kur përmasa e masave të tilla restriktive parashihet shprehimisht në legjislacionin tjetër që rregullon shërbimet dhe ofruesit e shërbimeve përkatëse

### **Neni 43** **Jodiskriminim në disponimintetin e këmbimit për mallrat e importuara**

43.1. Valutat të cilat janë të nevojshme për të paguar mallrat e importuara, për të cilat është e nevojshme leja për import do të jenë në dispozicion me emërtim, kushte, procedura dhe baza të njëjta sikurse valutat e huaja të cilat janë vënë në dispozicion për pagesat e mallrave të cilat nuk kanë nevojë për një autorizim të tillë.

43.2 Afatet, kushtet, procedurat dhe tarifatat e zbatueshme të transferit ndërkombëtar të fondeve për pagesat e mallrave të importuara nuk do të diskriminojnë në mes të mallrave të importuara që i nënshtrohen kërkesës për leje importi dhe mallrave të importuara që nuk i nënshtrohen lejes së tillë.

### **Neni 44** **Taksat dhe formalitetet**

44.1. Asnjë taksë nuk mund të vendoset mbi ose në lidhje me importimin ose eksportimin përveç kur qartë kanë të bëjnë me, dhe të domosdoshme për kompensimin e shërbimeve aktualisht të ofruara, në të gjitha rastet, çdo taksë e ngarkuar do të pasqyrojë koston faktike të shërbimeve realisht të ofruara dhe nuk do të përfaqësojë kufizim të fshehtë tregëtar, ose mënyrë për fitimin e të ardhurave për qëllime fiskale.

44.2 Në interes të efikasitetit, Qeveria mund të caktojë taksë fikse dhe/ ose taksë sipas vlerës së mallit të importuar dhe strukturat e taksës duke përcaktuar nivelet maksimale dhe minimale për shërbimet e ofruara rregullisht dhe zakonisht të ofruara lidhur me importin dhe eksportin; sidoqoftë, taksat e tilla dhe struktura e taksës do të jenë plotësisht në pajtim me direktivat dhe kërkesat e zbatueshme të OBT-së.

#### Neni 45 Transparenca

45.1 Nëse masa restrictive është e përfshirë në një marrveshtje ndërkombëtare dhe marrveshja e tillë parasheh afat të vacant në mes të dates së publikimit dhe dates së hyrjes në fuqi, atëherë masa e tillë restriktive nuk do të hyjë në fuqi deri sa afati i tillë të mos kalojë

45.2 Çdo akt normativ i nxjerr në bazë të këtij ligji do t'i përshkruaj mallrat që ndikohen me këtë në mënyrë të saktë, sikur që janë përcaktuar në legjislacionin doganor të Kosovës, veçanërisht në nomenklaturën e tarifave doganore.

#### Neni 46 Shkeljet dhe dënimet

Çdo akt normativ i nxjerrë sipas këtij ligji do të përmbajë dispozita që përcaktojnë në mënyrë të sakt dënimet që mund të shqiptohen për shkeljet e ligjit. Çdo akt i tillë normativ do të sigurojë që dënimet e tilla të jenë në përpjestim me shkallën dhe llojin e shkeljes gjegjëse dhe nivelin dhe shkallën e dëmit të shkaktuar nga shkelja e tillë.

### **Kapitulli 8** **Dispozitat përfundimtare**

#### Neni 47 Koordinimi me UNMIK-un

Veprimet dhe vendimet në Nenet 9.1, 12.4, 23.1, 24.1, 26.1, dhe 38.1 do të bëhen në koordinim të ngushtë me UNMIK-un.

#### Neni 48 Implementimi

Qeveria nxjerrë akte normative që janë të nevojshme për zbatimin e këtij ligji.

Neni 49  
Ligji aplikativ

Ky ligj do të zëvendësoj çdo dispozite të çdo rregullore ekzistuese apo ligji aplikativ i cili nuk është në përputhje me të.

Neni 50  
Hyrja në fuqi

Ky ligj hynë në fuqi me miratimin e tij nga Kuvendi, nënshkrimin e Kryetarit të Kuvendit kurse shpalljen e benë PSSP në pajtim me Kornizën Kushtetuese.

**Ligji nr.2002/6**  
**8 Maj 2003**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës,**  

---

**Akademik Nexhat Daci**